

Raport individual i konsultimit publik,

për projektligjin:

“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar

1. Titulli i projekt aktit

Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar.

Qëllimi i këtij projektligji është përditësimi dhe përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit kombëtar të peshkimit me acquis të Bashkimit Evropian, në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe detyrimeve që burojnë nga Kapitulli 13 “Peshkimi”. Në mënyrë të veçantë, projektligji synon reflektimin në legjislacionin kombëtar të ndryshimeve të sjella nga Rregullorja (BE) 2023/2842 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 22 nëntor 2023, e cila ndryshon Rregulloren (KE) nr. 1224/2009 për krijimin e sistemit të kontrollit të Bashkimit Evropian për garantimin e pajtueshmërisë me rregullat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit.

Në vitin 2024, nëpërmjet ndryshimeve të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar, u realizua përafrimi i pjesshëm i ligjit me një numër rregulloresh të Bashkimit Evropian, konkretisht me Rregulloren e Këshillit nr. 1224/2009/KE, Rregulloren e Këshillit nr. 2371/2002/KE, Rregulloren e Këshillit nr. 1967/2006/KE, Rregulloren e Këshillit nr. 1198/2006/KE, Rregulloren e Këshillit nr. 1005/2008/KE dhe Rregulloren e Këshillit nr. 104/2000/KE. Megjithatë, në vijim të procesit të screening dhe zhvillimeve të reja të acquis të Bashkimit Evropian në sektorin e peshkimit, u evidentua nevoja për përditësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor kombëtar, kryesisht në drejtim të monitorimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes së aktivitetit të peshkimit.

Ky projektligj synon forcimin e sistemit kombëtar të kontrollit të peshkimit, përmirësimin e gjurmueshmërisë së produkteve të peshkimit, digjitalizimin e proceseve të raportimit dhe monitorimit, si dhe krijimin e bazës ligjore për përdorimin e sistemeve moderne të monitorimit elektronik në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara synohet gjithashtu forcimi i kapaciteteve institucionale të monitorimit të flotës së peshkimit dhe rritja e eficiencës së mekanizmave për luftën kundër peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP).

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektligji iu nënshtrua procesit të konsultimit publik nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, për një periudhë prej 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik.

Publikimi u bë në datë 25.5.2026 dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJKP, ku të gjitha palët e interesuara:

- organet publike;
 - shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit;
 - personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe
 - personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë,
- ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektaktin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin public.

Data e mbylljes së procesit të konsultimit ishte 23.6.2026.

Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 320 shikime në platformën online, por nuk janë regjistruar komente në RENJKP.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërndanë informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar, ishin:

- Konsultimi elektronik përmes Regjistrit Elektronik, RENJK (25.5.2026 – 23.6.2026);

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Projektligji është përgatitur nga grupi i punës ngritur me urdhrin e ministrit nr. 320, datë 26.3.2026. Projektligji është në përputhje me Programin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) dhe me angazhimet e marra në kuadër të procesit të integritimit evropian për Kapitullin 13 “Peshkimi”.

Projektligji është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2030, si dhe me Strategjinë Ndërsektoriale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021–2027.

Nuk rezulton të ketë patur palë të interesuara (organizata të shoqërisë civile, subjekte private apo individë), të përfshira në procesin e konsultimit publik të projektaktit.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Nga procesi i konsultimit të projektligjit, nuk ka patur rekomandime lidhur me draftin e paraqitur.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
---	--	---	---	-------------